



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:185381
Datë: 28.05.2024
Numri i dokumentit: 05741750

Ac.nr.825/21

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Besnik Feka - kryetar i kolegjit, Arsim Hamzaj dhe Besnik Bislimaj-anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësve B. J. dhe D. J. që të dy nga fshati B., Komuna e S., të cilët i përfaqëson avokat F. G nga P. sipas autorizimit në shkresa të lëndës, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve "S." me seli në P., rruga xxxxx e përfaqësuar nga kompania e avokatëve A. me adresë rruga xxxxx në P. sipas autorizimit, me objekt kontesti kompensim dëmi nga auto përgjegësia, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë-Dega në Klinë, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.548/18 të datës 28.12.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur më **20.05.2024**, nxjerr këtë:

A K T G J Y K I M

I.REFUZOHET SI E PA BAZUAR ankesa e të paditurës Kompania e Sigurimeve "S." me seli në P., ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë-Dega në Klinë-Departamenti i Përgjithshëm, me numër C.nr.548/18, dt: 28.12.2020, në pikën **I, II, III, IV** dhe **V** të dispozitivit të tij **VËRTETOHET**.

II.Pikat VI dhe **VII** të dispozitivit të Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë-Dega në Klinë -Departamenti i Përgjithshëm, me numër C.nr. 548/18, dt: 28.12.2020, **ngelin të pa shqyrtuara**.

A r s y e t i m i

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar C.nr. 548/18, të datës 28.12.2020 vendos si në vijim:

APROVOHET PJESËRISHT SI E BAZUAR,kërkespacia e paditësve B.J. dhe D. J. që të dy nga fshati B. Komuna e S.

DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimeve "S." me seli në P. që paditësve në emër të dëmit jo-material dhe material t'ia paguaj shumat siç vijon më poshtë:

I.Në emër të demit jomaterial

Për B. J.

- dhembjet të perjetuar fizike shumë prej.....1,100.00 euro
- Per frikë të perjetuar shumë prej 900.00 euro

II.Në emër të dëmit material:

Në emër të shpenzimeve të shërimit shumë prej..... 5,0 euro

III. Në emër të dëmit jomaterial

Për D. J.

- dhembjet të përjetuar fizike shumë prej..... 1.000.00 euro
- Per frikë të përjetuar shumë prej 850.00 euro

IV. Në emer të dëmit material

- Në emër të shpenzimeve të shërimit shumë prej..... 5,0 euro

V. DETYROHET e paditura Kompania e sigurimit "S" me seli në P., që paditësve, shumat e gjykuara, për paditësin e parë B. J. shumë e përgjithme prej 2.005,00 euro të specifikuar si në pikën I dhe II të këtij dispozitivit dhe për paditësin e dytë D.J. shumë e përgjithshme prej 1.855,00 euro të specifikuar si në pikën III dhe IV të dispozitivit të këtij aktgjykimi e të gjitha këto në emër të dëmit jomaterial dhe material, me kamatë prej 8 % në vitë, duke filluar nga data 28.12.2020 e gjer në pagesën definitive, si dhe shpenzimet procedurale në lartësi prej 1.292,40 euro të gjitha këto në afatë prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi e nën kërcenim të përmbarimit.

VI. REFUZOHET kërkesëpadia e paditësve B. J. dhe D. J. nga fshati B., Komuna e S., përtej shumë së gjykuar si në pikën I, II III dhe IV të dispozitivit të këtij aktgjykimi, për pjesën e kërkespadië si e pa bazuar për shumat e specifikuar si me poshtë

Në emer të demit jo material:

Për paditësin B. J.

- Dhembjet të përjetuar fizike shumë prej..... 400.00 euro
- Për frikë të përjetuar shumen prej100.00 euro

Për paditësin D. J.

- Për dhembje të përjetuar fizike shumë prej.....500.00 euro
- Për frikë të përjetuar shumen prej650.00 euro

Në emër të dëmit material:

Për B. J.

- Për ndihmë dhe kujdes nga personat e tretë shumë prej prej.....200 euro
- Për shqim të përforcuar.....150 euro

Për D. J.

- Për ndihem dhe kujdes nga personat e tretë shumë prej200 euro
- Për shqim të përforcuar.....150 euro

V. REFUZOHET kërkesëpadia e paditësve me të cilën kan kërkuar që të detyrohet e paditura, që për shumat e gjykuara si në pikën I dhe II, III dhe IV të dispozitivit të ketijë aktgjykimi të ja paguaj me kamatë ligjore prej 12% në vit duke filluar nga data e parshtrimit të kërkesë të padisë e deri në pagesn definitive, nga ana e gjykatës për shumat e aprovuara ashtu siç është përshkruar në pikën V, të dispozitivit të ketijë aktgjykimi. dhe për shpenzime pertej shumë së aprovuare ,si të pa bazuar.

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit ligjor, ankesë ka paraqitur e paditura për shkak të shkelejeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, kontatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me propozimin që Gjykata e Apelit ta aprovjë ankesën si të bazuar, ta prish aktgjykimin e ankimuar dhe cështjen ta kthejë në gjykatën e shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Paditësit kanë ushtruar përgjegjje në ankesë duke i kundërshtuar në tërësi pretendimet ankimore të të paditurës me propozimin që Gjykata e Apelit ta refuzojë ankesën si të pa bazuar ndërsa aktgjykimin e atakaur ta vërtetojë.

Gjykata e Apelit e Kosovës pasi që i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, e pas vlerësimit të tyre, në kuptim të neneve 194 dhe 195, paragrafi, 1, pika (d), lidhur me nenin 200, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) dhe gjeti se:

Ankesa e të paditurës Kompania e Sigurimeve “S.” me seli në P., është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se B. J. dhe Da. J., nga fshati B., Komuna e S., përmes përfaqësuesit të tyre të autorizuar, F. G., avokat nga P., me datë 8.12.2018, kanë ushtruar padi për kompensim dëmi kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve ”S.” me seli në P.. Në shqyrtim kryesor dhe në fjalën përfundimtare të parqitur me shkrim kanë deklaruar se nga provat e administruara u vërtetua baza juridike dhe lartësia e kërkespadiës, bazën juridike nuk e ka kontestuar e paditura sa i përket paditësit B.J., ndërsa e ka kundërshtuar bazën juridike vetëm për paditësin D. J. ku ka theksuar se sipas raporti të policis D. J. nuk ka qenë i përfshire në aksident. Se paditësi i dytë ka qenë pjesmarrës në aksidentin e datës 09.07.2018, në të cilin ka përuar lëndime përveç raportit mjekësor të lëshuar nga QKMF Klinë me nr protokol 4837 është vërtetuar edhe me ekspertizë mjekësore të nga ekspertet e caktuar Dr.Enver Mujaj ortoped dhe Dr. Muhamet Halitaj Specialist i Psikaitrisë,gjithashtu edhe dëshmitari Lavdim Mustafaj, i cili ka deklaruar se aksidenti ka ndodhur pran lokalit të tij.

E paditura, përmes përfaqësuesit të autorizuar,ka ushtruar përgjegjje në padi nuk e ka kundërshtuar bazën juridike për sa i përket paditësit B.J.por e ka kundërshtuar lartësinë ku sipas të paditurës lartësia e kërkespadiës nuk përkon me lëndimet e paditësit të cilat janë cilësuar si lëndime të lehta trupore, po ashtu ka deklaruar se qëndron pranë ofertës së dhënë për paditësin B. J., ndërsa e ka kundërshtuar bazën juridike për sa i përket paditësit D. J..

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit, ka caktuar seance gjyqësore e cila sënë është mbajtur në mungesë të të paditurës konfirm nën 423 paragrafi 3 të LPK-së, pas administrimit të provave të propozuara nga palët ndërgjyqëse, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.458/18 të datës 28.12.2020, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht të bazuar kërkesëpadinë, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetimin e këtij aktgjykimi, gjykata e shkallës së parë ndër të tjera ka theksuar nga provat e administruara u vërtetua fakti se me datë 09.07.2018 rreth orës 14:23 ,në fshatin Klinafc, Komuna e Klinës është shkaktuar aksidentë komunikacioni në të cilin paditësit, B. J. ka qenë në cilësinë e drejtuesit të automjeti B, ndërsa D. J. në cilësinë e pasgjerit dhe të dytë kanë përsuar lëndime të lehta trupore. Për sa i përket paditësit B. J. nuk ka qenë kontestuese baza ligjore e kërkespadiës por vetëm lartësia e kërkespadiës por e paditura e ka kontestuar bazën ligjore sa i përket paditësit D. J.. Nga ekspertiza e komunikacionit rrugor e ekspertit Kreshnik Rugova e nxjerrur në Prokurorinë Themelore në Pejë PP/II-nr 2104/2018 të datës 01.11.2018 është kontaktuar se deri te aksidenti ka ardhur si pasojë e lëshimeve të automjeti A të tipit Audi A3, sepse e ndërmer veprimin e tejkalimit në mënyrë të menjëhershme dhe pa u siguruar se këtë veprim mund të bëjë në mënyrë të sigurt dhe pa i penguar pjesmarrësit e tjerë në komunikacion, me një shpejtësi të rrezikshme prej 100 km /h shpejtësi kjo dukshëm më e madhe se shpejtësia maksimale e lejuar në atë pjesë të rrugës e cila është e kufizuar në shpejtësi 50 km/h, po ashtu nuk e mban distancën e lejuar dhe mjaftueshëm të sigurtë në mes të mjetit të tij dhe automjeti që kishte por fillon tejkalimin përkundër faktit se automjeti B i tipit VË Golf 19 ishte në kthesë e sipër dhe në meometin kritik nga shpejtësia e madhe e lëvizjes dhe tejkalimit të pasigurtë, nuk ka mund ta ndalë automjetin e tij duke e goditur me pjesën e parë të automjetit B në pjesën e parë të anës së majtë ,ndërsa automjeti A i tipit Audi A3 nuk ka mundur ta ndalë automjetin e tij pas goditjes së parë por vazhdon edhe për rreth 26 m dhe e godet automjetin C i cili ishte i ndalur parkuar jashtë rrugës ,e kjo mënyrë jo e rregullt e ngasjes dhe e tejkalimit i pasigurt ,shpejtësisë së madhe të lëvizjes ka rezultuar shaktar i aksidentit.Po ashtu, për të e vërtetuar bazën juridike të kërkespadiës

sa i përket paditësit të dytë ,me propzimin e palës është nxerrur prova përmes dëgjimit të dëshmitarëve,sipas proceverbalit të datës18.11.2020, Agron Hasanaj polic pranë stacionit policore në Klinë u dëgjua si dëshmitar, në rastin konkret kemi konstatuar se me vozitësi i automjeti B më ka thënë që kam edhe një femijë me veti,unë i ka then shkoni të mejku se nuk jeni mirë.Po ashtu,është vazhduar me deklarimin e dëshmitarit Lavdim Mustafaj ku i njeta ka ka deklaruar se aksidenti ka ndiodhur në fshatin Klinafvc në gjysmën e përpjetëzes, une kam qen ne lokale dhe kam dalur menjher si kam dëgjuar një krismë. Si ka ra një vetur me poshtë dhe nuk ka mundur mu ndal dhe ka ardhur dhe i ka ra një veture tjetër në parking ton.Nuk kam mundur mi pa kur kan dalurur nga kerri nuk kam qen i pranishëm. Në veturën e B. J. ka qen dikush tjetër po ka qen edhe djali i tij dhe të nejtin i kemi dhen ujë për me pi. Mandej kemi thirr policin,se kur kan dalur jasht kan qen tre vetë ,ku une kam komunikuar se pari me B. dhe i kam then se a pshtut e menjher e kam pyetur D. a mos je vra dhe se kerri i B. me të Elmise ka pasur përfasishte 20 metra lagësi se kta kan qenë afër asfaltit, kerri i tij ka qen 10-12 metra larg lokalit tim.Kur ka ndodh aksidenti kan qen tre vet dhe kemi shkuar brendna një minuti dhe vetëm pastaj kan ardhur plot persona tjerë,ku i kujtohet se D. ka ndejtur aty, më duket se ka nejtur një gjysmë ore derisa sa kan ardhur me heq kerrin nga rruga. Në cilësinë e palës është ndëgjuar edhe B. J. ku ka deklruar se në ditën kritke kam pasur vetëm djalin tim D. kam qen në Klinë kam qenë duke punuar, në lokalin tim dhe nuk kam pasur punë dhe kam shkuar me rregulluar kerrin, ku ka ardhur nje audi, ku e ka përshkruar fotografjin të paraqitur, ku ka treguar se unë jam me dore në fytyrë, ndrësa D. është me një bluzë me vija. Te mjeku kemi shkuar menjëher unë dhe Elmija , ndërsa djali masanej.Në kohën kur me ka goditur, kam dal nga kerri dhe Lavdimi na ka thenë se pije do ujë djalit se ti je me i ri pi pak ujë. D. J. në cilësinë e dëshmitarit ka deklaruar se më kujtohet dita kur ka ndodhur aksidenti, kemi qen në Klinë sespe, kemi pasur pasuzë dhe na u prish vetura dhe kemi shkuar për tëLavdimi në Klinfcë ,kur babi ka dhënë shenjë dhe une kam qen në karrigen e parë ulur në vetur dhe e kam vetur baben e ke dhimbje dhe ka ardhur Lavdimi dhe na ka pyetur se a jemi mirë dhe na ka dhënë ujë me pi. Babi dhe Qupeva kan shkuar te mjeku dhe une pas 24 orëve, atë natë kam pasur stres, ëndrra dhe dhimbje në shpinë dhe në qafë dhe të nesemen kam shkuar tek mjeku në ambulancë në Klinë. Gjykata ia fali besimin dëshmitarëve dhe palëve ndërgjygjëse dhe kontatoi se në këtë aksident kanë ka qenë edhe paditesi i dytë, D. J.. Ndërsa për të vërtetuar se paditësit në aksidentin e ndodhur kanë pasur lëndime trupore dhe për ta vërtetuar lartësinë e kërkespadiisë, gjykata ka nxjerrë provat me ekspertizë mjeksore nga eksperti i ortopedisë dhe neuropsikiatrisë të datës 12.08.2020 ku si eksperti ishin Dr.Enver Muja ortoped-traumatolg dhe Dr.Muhamet Halitaj Psikiater kanë klontatuar se paditësi B. J. dhe D. J. si pasojë e aksidentit kanëpëruar lëndime të lejta trupore. Gjyakta, për paditësin B. J., në emër të dhimbjes fizike e aprovoi kërkespadiinë në shumë prej 1.100, 00 euro dhe e vlrësoi si shpërblim të drejtë dhe që i shërben qëllimit të shpërblimit sepse paditësi sipas mendimit të ekspertit ortoped /traumatolog , si pasojë e lëndimeve të marrura ka pësuar dhimbje fizike të intestitetit posaqërisht të lartë për rreth 2 minuta deri në ofrimin të ndihmës mjeksore,dhimbje fizike të intezitet të lartë në kohezgajtej prej 1orë, dhimbja fizike të intesteit të mesëm ka pasur 7 ditë, ndërsa dhimbja fizike të intezitet të ulët ekzistojnë ende me rastin e ndërimeve të kushteve klimatike dhe sforcimeve fizike. Në emër të frikës së pësuar gjykata e ka caktuar shpërblimin në shume prej 900 euro dhe ka vlrësuar si shpërblim të drejtë ,duke u nisur nga fakti se sipas mendimit të ekspertit mjeksore të psikiatrisë, paditesi ka pësuar frikë primaret të intesitetit të lartë në kohëzgjajte prej disa skondave e përcjellur me shtangim afektiv, frike sekondare të intezitet të lartë ka pasur në periudhë kohore prej 2 orë të përcjellura me frymarrje të vështirësuar ,të rrahura të shpejtuara të zemrës ,dridhje të muskujve dhe ankesa tjera trupore.Frikë me intesitet të mesëm ka pasur në periudhë kohore prej katër javë të përcjellura me cregullim të aktvitetit psikofizik,pagjumesi ,prag më të ulët të tolerancës frustive si dhe ankesa tjera somatike, ndërsa frikë sekondare me intezitet të ultë ka pasur në periudhë kohore gjer në dy muaj e manifestuar gjatë kohës kur ka udhetuar apo ngjarje që ja perkujtojn aksidnetin. Gjykata, për paditesin D. J. në emër të dhimbjes fizike e aprovoi kërkesë në shumë prej 1.000,00 euro dhe e vlrësoi si shpërblim të drejtë dhe që i shërben qëllimit të shpërblimit

sepse si pasojë e lëndimeve ka përjetuar dhimbje fizike të intesitetit posacërisht të lartë, dhembje fizike të intesteti të lartë kan qenë në kohëzgjatje prej 1 orë, dhimbja fizike të intezitet të mesëm ka pasur 5 ditë, dhimbje fizike e intezitet të ulët ka edhe sot her pas herit sidomos në ndërimin e kushtev klimatike dhe sforcimet fizike. Në emer të frikes së pësuar gjykata e ka caktuar shpërblimin në shume prej 850 euro dhe ka vlerësuar si shpërblim të drejtë ,duke u nisur nga fakti se sipas mendimit të ekspertit mjeksore të psikiatrisë ka konstatuar se frik primare nuk ka pasur, frike sekondare të intezitet të lartë ka pasur në periudhë kohore prej 1 orë të përcjellura me frymarrje të vështurësuar dhe të rrahura të shpejtuara të zemrës ,dridhje të muskujve dhe ankesa tjera, frike me intesitet të mesëm ka pasur në periudhe kohore prej katër jav të percjellra me cregullim psikkofizike si pasojë e aksidentit si indisponim,pagjumësi, prag të ulët të tolerancës frustive si dhe ankesa tjera somatike, frike sekondare me intezitet ultë ka pasur në periudhë gjer në dy muaj e që është manifestuar gjatë kohës kur ka udhëtuar apo ngjarje që ja përkujojn aksidnetin. Ndërsa sa i përket dëmit material për paditësin B. J. dhe atë në emer të shpenzimeve të mjekimit e aprovoj shumën prej 5.00,00 euro bazuar në dëftesën nr 024235 të lëshaur nga QKMF Nëna Terezë, në Klinë, ndërsa për paditësin, D. J. në emer të shpenzimeve të mjekimit shumën prej 5.00,00 bazuar në dëftesën 023954 e lëshaur nga QKMF Nëna Terezë, në Klinë. Gjykata e aprovoj pjesërisht kërkespadinë e paditësit duke e bazuar vendimin e saj në nenin 136, 159,179,183 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, nenit 323 të LPK-së. Për sa i përket llogaritjes së kamatës ligjore, gjykata vendimin e bazoi në nenin 382 të LMD-së, ndërsa për sa i përket shpenzimeve të procedurës vendosi sipas nenit 449 dhe 452 të LPK-së.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata e Apelit vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) i LPK-së, gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe plotësisht, si dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e po ashtu ky aktgjykim nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave nga e drejta materiale, të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Gjykata e Apelit e Kosovës, nuk gjeti as shkelje që i referohen konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, e as shkeljeve të tjera nga neni 181 pparagrafi 1 dhe 182 paragrafi 2, pasi që arsyetimi i aktgjykimit është në përputhje me dispozitën e nenit 160, paragrafi 4 dhe 5 të LPK-së, meqë gjykata e shkallës së parë, ka dhënë arsye të mjaftueshme për faktet e çështjes, për provat që i ka shfrytëzuar për vërtetimin e fakteve dhe vlerësimin e tyre dhe se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke bërë kështu që dispozitivi dhe arsyetimi, si dy pjesë përbërëse të aktgjykimit, të jenë në harmoni logjike dhe juridike me njëra tjetrën. Gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për aprovimin e pjesërishtëm të kërkesëpadisë së paditësve e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet, e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar. Në këtë kontest, në arsyetim të aktgjykimit janë dhënë arsye të duhura për mënyrën e vërtetimit të fakteve, për provat e administruara dhe për vlerësimin e tyre sa i përket besueshmërisë dhe fuqisë provuese të tyre. Kështu, gjykata e shkallës së parë, në arsyetim të aktgjykimit ka paraqitur arsye të mjaftueshme për aprovimin e pjesërishtëm të kërkesëpadisë së paditësve

Një ashtu, edhe e drejta materiale është zbatuar drejtë nga gjykata e shkallës së parë, kur me rastin e vendosjes, është zbatuar neni 136, paragrafi 1 i LMD-së, që përcakton se “*Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij.*”, dhe gjithashtu edhe neni 179 të LMD-së që përcakton se “*Kush i shkakton tjetrit*

lëndim trupor ose ia dëmton shëndetin ka për detyrë të shpërblejë shpenzimet rreth mjekimit dhe shpenzimet tjera të nevojshme lidhur me këtë, si dhe fitimin e humbur për shkak të paaftësisë për punë gjatë kohës së mjekimit”, në rastin konkret i siguruari i të paditurës ka përgjegjësi ekskluzive në shkaktimin e aksidentit, e cila është vërtetuar nga ekspertiza e komunikacionit, pra drejtë është zbatuar dispozita e nenit 179 në lidhje me nenin 136 të LMD-ës. Gjykata e shkallës së parë drejtë e ka zbatuar të drejtën materiale me rastin e referimit në dispozitën ligjore të nenit 136 të LMD-së e cila dispozitë rrjedh përgjegjësia për shpërblimin e dëmit, prandaj, mbi bazën e të gjitha këtyre arsyeve, gjykata e shkallës së dytë, vlerëson se pretendimet ankimore të palës së paditur në raport me mënyrën e vendosjes së gjykatës së shkallës së parë, rezultojnë të pabazuara dhe pa argumentuara dhe si të tilla refuzohen.

Ndërkaq, edhe pretendimet ankimore të të paditurës se shumata e aprovuara nga gjykata e shkallës së parë për kompensimin e dëmit jo material dhe material janë të larta, gjykata e shkallës së dytë i vlerëson si të paqëndrueshme dhe të pabazuara, sepse gjykata e shkallës së parë ka gjykuar shumata në bazë të vlerësimeve profesionale të ekspertëve mjekësor në ekspertiza e tyre të cilët kanë konstatuar lëndimet e pësuar nga paditësit janë të natyrës së lehtë trupore. Andaj, për këtë gjykata e shkallës së parë me të drejtë është bazuar në dispozitat e nenit 183 të Ligjit nr.04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, si dhe kriteret dhe masat për caktimin e shpërblimit jo material, e sidomos duke pasur parasysh shkallën e dhimbjeve fizike dhe frikës, për çka edhe Gjykata e Apelit i ka vërtetuar shumata e kompensimit të gjykuara nga gjykata e shkallës së parë. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, duke marrë parasysh natyrën e lëndimeve, si dhe kohëzgjatjen e dhimbjeve dhe frikës, është vendosur që të vërtetohen shumata e kompensimit në emër të dëmit jo material të shkaktuar, mbështetur edhe në thëniet e ekspertizave mjekësore ku janë trajtuar këto forma të dëmit. Gjatë vendosjes lidhur me to, gjykata e shkallës së parë, është mbështetur siç duhet në nenin 183, par. 2 të LMD-së, i cili decidivisht thotë se: *“Me rastin e vendosjes për kërkesën mbi kompensimin e dëmit jo material si dhe mbi shumën e kompensimit të tij, gjykata do të ketë parasysh për rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe të qëllimit të cilit shërben ky kompensim e gjithashtu edhe për faktin se mos të u shkojë përshtat synimeve që nuk janë të pajtueshme me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror”*. Nga interpretimi i kësaj dispozite ligjore, rezulton se kompensimi duhet të jetë adekuat me natyrën e lëndimit, intensitetin dhe kohëzgjatjen e dhimbjeve të përjetuara, si dhe frikës së palës së dëmtuar, ashtu që kompensimi të përfaqësojë një lehtësim në përbalimin dhe tejkalimin e pasojave të dëmit që në këtë rast pala paditëse ka pësuar në aksidentin e ndodhur, e që në të njëjtën kohë, ato të jenë reale dhe të paraqesin satisfakcion të vërtetë, për aq sa është e mundur, duke u shkuar për shtati synimeve shoqërore për kompensimin e dëmit. Si rrjedhojë, nga arsyet e cekura si më lartë edhe pretendimet ankimore të të paditurës se gjykata e shkallës së parë ka gjykuar shumata pa u mbështetur në asnjë dispozitë ligjore janë plotësisht të pabazuara.

Gjithashtu, sa i përket kamatëvonesës, gjykata e shkallës së parë, drejtë ka aplikuar të drejtën materiale, ku i është referuar nenit 382 par.1 dhe 2 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve nr. 04/L-077, si dhe momentit të përcaktimit të rrjedhjes së saj, dhe kjo vendosje pranohet edhe nga gjykata e shkallës së dytë, ngase është në përputhje edhe me Mendimin Juridik për Kamatën të miratuar nga Gjykata Supreme e Kosovës nr. 265/20, datës 01.12.2020, gjegjësisht pikën II, V dhe XIV dhe XV të këtij mendimi, ku përcaktohet ligji i aplikueshëm, shkalla e kamatëvonesës dhe periudha e rrjedhjes së saj dhe vendosja nga gjykata e shkallës së parë është në përputhje me këto pika, ka gjykuar shkallën e kamatëvonesës prej 8% vjetore nga data e ushtrimit të padisë për dëmin material ndërsa për dëmin jo material nga data e nxjerrjes së aktgjykimit nga gjykata e shkallës së parë, e të cilën vendosje e pranon edhe gjykata e shkallës së dytë.

Sa i përket shpenzimeve të procedurës gjykata ka vendosur në mënyrë të duhur sepse i ka arsyetuar shpenzimet e gjykuara për secilin veprim të ndërmarrë në procedurën kontestimore, e të cilat veprime edhe sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit kanë qenë të domosdoshme në mënyrë

që gjykata të vendosë për themelësinë e kërkesëpadisë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme. Lartësia është në përputhje me tarifën për përfaqësim dhe po ashtu në përputhje me tarifën për taksa gjyqësore dhe ekspertiza. Pala e paditur është obliguar për pagesën e shpenzimeve procedurale bazuar në dispozitën ligjore të nenit 452 paragrafi 1 të LPK së ku parashihet se *“pala e cila e humbë procesin gjyqësor tërësisht ka për detyrë që palës kundërshtare gjyq fituese, dhe ndërhyrësit që i është bashkuar, t’ia shpërblej të gjitha shpenzimet gjyqësore”*, në rastin konkret e paditura e ka humbur procesin gjyqësor.

Meqë, aktgjykimi i ankimuar nuk është atakuar në pikën **VI dhe VII** të dispozitivit të tij (pjesën refuzuese të kërkesëpadisë dhe kërkesës për kamatë 12%), atëherë gjykata e shkallës së dytë, referuar nenit 194 të LPK-së (kufinj të e ekzaminimit të ankesës), si dhe nenit 203 të LPK-së, këto pika të aktgjykimit të ankimuar nuk i shqyrtoi fare.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore të të paditurës, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga sa u tha më lartë, Gjykata e Apelit vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e në bazë të nenit 195 paragrafi 1 pika (d) lidhur me nenin 200 të LPK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.825/21, me datën 20.05.2024

Kryetari i Kolegjit-Gjyqtari
Besnik Feka